



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 163/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë, paraqitur kundër Iniciativës Qytetare në Malishevë (IQM), për shkak të dëmtimit të veturave, për Zgjedhjet lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10. 2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 05.10.2013 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK, dega në Malishevë, me të cilën pretendohet se me datën 04.10.2013 në fshatin Damanek gjatë mbajtjes së tubimit elektoral simpatizantët dhe aktivistët e Iniciativës Qytetare në Malishevë (IQM) kanë dëmtuar veturat e kandidatëve Asllan Kastrati dhe Alush Krasniqi kandidat për këshilltar komunal nga rradhët e PDK-së duke ju shënuar në veturat e tyre grafite me përmbajtje të akronimit IQM dhe se po të njëjtat grafite janë shënuar edhe në veturat private të anëtarit të kryesisë së PDK-së Muj Sahitajt dhe veprimtarit Fatmir Kilajt. Në ankesë më tutje theksohet se përveç dëmtimit të veturave me ngjyrë ato janë dëmtuar me mjete të forta duke i gërvishur ato. Andaj me k

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 05.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik nga ana e PDK-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.10.2013, në ora 12:00.

PZAP-i, me datën 07.10.2013, mori përgjigjen e kërkuar nga IQM-ja lidhur me ankesën e paraqitur nga PDK-ja, në të cilën theksohet se akuzat e PDK-së në drejtim të aktivistëve të IQM-së janë të pavërteta dhe tendencioze dhe se për këtë IQM-ja është në gjendje që të ofroj dëshmi apo prova se kandidatët se kandidatët e apostrofuara nga PDK-ja, nga ora 18:00 deri në orën 22:00 kanë qenë prezent në aktivitetet e fushatës zgjedhore të IQM-së në fshatin Maxharrë, Shkozë dhe Damanek. Lidhur me këtë edhe vetë deklaratë e kandidatit të PDK-së Isni Kilaj janë të paqarta dhe të pabazuara në fakte, pasi që në deklarimin e tij gjatë fushatës zgjedhore në fshatin Bubavec thekson se për këtë dyshon në aktivistët e LVV-së

Në raportin e policisë me nr. 2013-GE-653 të datës 09.10.2013, të lëshuar nga oficeri policor Bekim Begaj theksohet se me datën 04.10.2013 PDK-ja dega në Malishevë ka mbajtur tubim elektorale në fshatin Damanek të Malishevës, ku tubimi në fjalë ka filluar nga ora 18:00 dhe ka zgjatur deri në 19:40 e i cili tubim është mbajtur në një odë private (shtëpi private). Këtë tubim e kanë monitoruar 2 zyrtarë policorë të stacionit policor të Malishevës dhe gjatë gjithë kohës sa kanë monitoruar aty nuk kanë vërejtur ndonjë parregullsi apo ndonjë incident dhe se me të përfunduar tubimi në fshatin Damanek policia ka shkuar që ta monitoroj një tubim tjetër elektorale në fshatin Llapqevë të Malishevës. Më tutje në raportin e policisë theksohet se të nesërmen rreth orës 20:00 në stacionin policor janë paraqitur dy persona në cilësinë e ankuesit duke raportuar se veturat e tyre ishin dëmtuar me sprej ngjyrë të kuqe duke ju shënuar akronimet e IQM-së si dhe se ju ishin gërvishur me mjete të forta.

Në raportin e Policisë së Kosovës theksohet se me datën 05.10.2013 për rastin në fjalë janë angazhuar 3 policë hetues nga stacioni policor i Malishevës dhe 1 nga stacioni policor i Prizrenit ku gjatë këtyre hetimeve policët hetues kanë intervistuar 4 persona në cilësinë e të dyshuarve dhe dy në cilësinë e dëshmitarëve dhe se gjatë deklarimeve të tyre asnjëri nga ta nuk ka pranuar që ka kryer një veprim të tillë apo të ketë pasur lidhje me rastin në fjalë. Për këtë çështje policia e Kosovës është në përfundim të kompletimit të rastit dhe se rasti në fjalë do të kalojë Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

Ankesa është e pabazuar.

PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për ti vërtetuar pretendimet ankimore, kjo vërtetohet edhe përmes raportit të policisë me nr. 2013-GE-653 të datës 09.10.2013, në të cilën theksohet se gjatë ndërmarrjes së veprimeve hetimore nga ana e Policisë së Kosovës nuk kanë arritur të bëjnë identifikimin dhe zbulimin e kryesve të shkeljes së supozuar dhe se për këtë rast çështja do të procedohet në Prokurorinë kompetente, prandaj PZAP-i vendosi se një pretendim i ankesës është i pa argumentuar dhe i pa bazuar në fakte dhe prova dhe si e tillë ankesa është e pa bazë, andaj në kuptim të nenit 115.1 lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrë

A nr. 163/2013 më datën 09.10.2013

Kryesuesi i panelit
Muhamet Rexha



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*